

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuere, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Qershor, 2021

Sesioni i Posaçëm i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi "Sfidat dhe Masat për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit"

02-04.06.2021. Ministri i Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit mori pjesë në punimet e Sesionit të Posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për luftën kundër korrupsionit, mbajtur në Nju Jork. Ky sesion zhvillohej për herë të parë nga OKB dhe ishte i fokusuar në diskutimin për rëndësinë e masave parandaluese dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për të forcuar luftën kundër korrupsionit. Përpjekjet e Qeverisë shqiptare në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, angazhimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të gjetur mënyra dhe mjete të reja për të luftuar korrupsionin, ngritja dhe funksionimi i organeve të reja në luftën kundër korrupsionit dhe kërkit të organizuar në kuadër të përpjekjeve ndëshkuese kundër korrupsionit ishin referenca e fjalës së mbajtur në këtë Asamble. Në përfundim të sesionit 3-ditor, nga shtetet anëtare u miratua deklarata politike e përbashkët për masat parandaluese dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për të forcuar luftën kundër korrupsionit.



Forumi Rajonal i nivelit të lartë për miratimin e Udhërrëfyesit Rajonal "Antikorrupsioni dhe Financimet e Paligjshme"

21-25.06.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, mori pjesë në Forumin Rajonal të përfaqësuesve (teknikë dhe politikë) të nivelit të lartë, të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Ohër. Forumi rajonal për hartimin dhe miratimin e Udhërrëfyesit Rajonal me temë "Antikorrupsioni dhe Financimet e Paligjshme", vjen si një përpjekje rajonale e përbashkët, e qenësishme dhe e koordinuar, për të luftuar korrupsionin. Udhërrëfyesi bazohet në angazhimet e marra nga vendet e Ballkanit Perëndimor në Samitin e Londrës, në kuadër të Procesit të Berlinit dhe në rezultatin e sesionit të parë special të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNGASS). Në këtë takim u rikonfirmua angazhimi maksimal i Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Drejtësisë për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe paligjshmërisë, si edhe gatishmëria për të ndarë praktikat më të mira me vendet e rajonit.




Marrëveshje bashkëpunimi midis Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ambasadës Italiane në Tiranë, për pilotimin e modulit antikorrupsion

15.06.2021. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në rolin e institucionit përgjegjës për arsimin dhe edukimin dhe Ambasada Italiane në Tiranë, firmosën një marrëveshje bashkëpunimi, nëpërmjet të cilës do të pilotohet një projekt edukativ në fushën antikorrupsion. Projekti do të implementohet për herë të parë, nëpërmjet një moduli antikorrupsion, në institucionet arsimore para-universitare duke filluar nga muaji Shtator. Nëpërmjet tij synohet që të parandalohet korrupsioni, përmes ndërgjegjësimit të nxënësve që në një moshë të hershme dhe promovimit të integritetit. Bashkëpunimi strategjik i të tre institucioneve është hapi i parë i ndërthurjes së ekspertizës ligjore dhe strategjike, asaj në arsim si edhe praktikave më të mira nga Italia, për të promovuar dhe rritur gjithëpërfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, dhe në veçanti të brezit të ri në luftën kundër korrupsionit.



Mbledhja e Komitetit Koordinator të SNKK për miratimin e raportit 3-mujor të monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion

17.06.2021. Komiteti Koordinator për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit mbajti takimin e parë për periudhën raportuese të vitit 2021, në të cilin u miratua Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, për periudhën Janar-Mars 2021. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e institucioneve të përfshira në Strategji, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, si edhe përfaqësues të donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë strategjikë. Gjatë takimit u diskutua gjithashtu edhe për ecurinë e punës për hartimin dhe miratimin e Planit të Integritetit në institucionet e qeverisjes qendrore, si një nga masat e planit aktual të veprimit të SNKK, si edhe si një nga rekomandimet e GRECO.



Mblidhet Grupi i Punës për vlerësimin dhe ngritjen e Zyrës Shqiptare të Rikuperimit të Aseteve

14.06.2021. Grupi i Punës për krijimin e Zyrës Shqiptare të Rikuperimit të Aseteve, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 49, datë 23.05.2021, mbajti dy mbledhjet e para, përkatësisht në datat 14 dhe 30 Qershor. Fokusi i punës së këtij grupi është analiza e kuadrit ligjor ekzistues, vlerësimi i nevojës për ndryshime të mundshme ligjore, si edhe vlerësimi i ngritjes dhe organizimit të strukturës së Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në lidhje me varësinë funksionale, financiare dhe fushën e kompetencës. Ngritja e kësaj zyre është në përputhje me masat e parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit, si edhe në përmbushje të rekomandimeve të raporteve të Komisionit Evropian. Grupi i punës kryesohet nga Zëvendësministri i Drejtësisë dhe pjesë e tij janë edhe përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, SPAK, Policia e Shtetit, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Vendimmarrja do të jetë pjesë e një diskutimi të hapur me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të fushës, si edhe aktorë të shoqërisë civile.



Cikli i trajnimeve me pikat e kontaktit antikorrupsion

18.06.2021. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian për Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe ASPA, filloi ciklin e trajnimeve për pikat e kontaktit antikorrupsion. Trajnimi synon të pajisë me njohuri të plota në lidhje me procesin e raportimit dhe monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, të gjithë pikat e kontaktit antikorrupsion sipas institucioneve të identifikuar në strategji. Objektivi kryesor i këtij cikli trajnimesh është përmirësimi i cilësisë së raportimit, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, forcimi i kapaciteteve në hartimin dhe zbatimin e mekanizmave antikorrupsion, përdorimi i instrumenteve të fushës si integriteti, etika dhe rregullat e sjelljes, sinjalizuesit, mjetet e komunikimit antikorrupsion, etj. Trajnimet gjatë muajit Qershor janë zhvilluar në datat 18, 21 dhe 29.



Trajnim i Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

24.06.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me Projektin e Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian në Ministrinë e Drejtësisë, zhvilluan një trajnim një-ditor me anëtarët e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Pjesëmarrësit u njohën me metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit, evidentimin e faktorëve të riskut dhe hartimin e masave për adresimin e tyre. Hartimi dhe miratimi i Planeve të Integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë është një nga masat e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, parashikuar për t'u përmbushur brenda vitit 2021.



"Jep Alarmin", sinjalizo për të luftuar korrupsionin!

10.06.2021. Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si edhe Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë organizoi aktivitetin "Jep Alarmin"/"Whistle for the End" për promovimin e rolit të sinjalizuesve në luftën kundër korrupsionit. Nëpërmjet angazhimit në këtë aktivitet, duke sinjalizuar në mënyrë simbolike, qytetarët e Tiranës arritën të kursejnë rreth 20,509,200 Lek, të cilat do të mund të investoheshin për të përmirësuar jetën dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Aktiviteti u zhvillua në ambient të hapur në Tiranë në prani të qytetarëve dhe me një gjetje interesante, siç ishte ndalimi i grirjes së kartëmonedhave sapo jepej alarmi për rast korrupsionit. Me këtë aktivitet, Tirana iu bashkua kryeqyteteve të Ballkanit Perëndimor në këtë iniciativë.

